

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si apelohe vendimi i Gjykatës Speciale për krerët e UÇK-së
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/si-apelohe-vendimi-i-gjykates-speciale-per-kreret-e-uck-se/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:19:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:12:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	83115c958729e002051386d6e6250332134640b940acbbb688597b5f44c3e1b1
TEKSTI	8ca21869b8a5ade8068716d949c05139d184dc8b908d96f00cbe0ffc2db80fe9
PAMJA	3f7c3009e801535850ed975eee2087c9ab004275c019d72468db4268e6cd5435

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	53a2deec2a481c616e7029bc683a80387e25e172a54f2fbd4645109aff110fe9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/53a2deec2a481c616e7029bc683a80387e25e172a54f2fbd4645109aff110fe9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Si apelohe vendimi i Gjykatës Speciale për krerët e UÇK-së

22:12 : 16/09/2026 në RAJONI



Ekipe mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë aktgjykimin dënues të shqiptuar nga trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator. Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës për krime lufte, Jakup Krasniqi po ashtu u dënua me 25 vjet burgim, ndërkaq Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën penalisht përgjegjës për krime lufte që përfshijnë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Gjatë aktgjykimit të shqiptuar në Hagë, trupi gjyqësor hodhi poshtë akuzat e ZPS-së për krime kundër njerëzimit. Katërshja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Vendimi i trupit gjyqësor mund të apelohe nga palët e përfshira, nga mbrojtja e cila mund të kërkojë rrëzimin e aktgjykimit në tërësi apo të synojnë uljen e dënimit për pika të caktuara të akuzës, por edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që mund të kërkojë ashpërsim të dënimit. ZPS-ja mirëpriti vendimin dënues dhe shtoi se do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin, përfshirë edhe rrëzimin e pikave të akuzës që kishin të bënin me krime kundër njerëzimit.

Por, cilat janë procedurat që palët ndjekin për apelim?

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, palët që apelojnë vendimin e gjykatës ose dënimit, ose të dyja së bashku, duhet të dorëzojnë atë që quhet njoftimin për apel, ku parashtrihen arsyet e apelim, 30 ditë nga shpallja e aktgjykimit.

Lexo edhe:

[‘Liria Ka Emër’/ Dua Lipa reagon ndaj vendimit në Hagë](#)
[Turqia dënon sulmin me dron ndaj Mekës në Arabinë Saudite](#)

Më pas, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit – gjykatë që përbëhet nga tre anëtarë – mund të caktojë një prej gjykatësve si gjykatë raportuese për procedurën paraapeluëse. Gjykatësi raportues ka për detyrë të marrë masat e nevojshme për aspektet procedurale, sikurse janë lëshimi i vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve me qëllim që të përgatitet çështja për shqyrtim. Ai duhet që rregullisht ta informojë panelin e Gjykatës së Apelit, veçmas nëse ka kontestime lidhur me çështjet procedurale.

TË GJITHA



Falsifikimi i pronave në Seman/ Arrestohen ish-kreu i Kadastrës dhe biznesmeni Kastriot Hasko

22:16 : 16/09/2026



Si apelohe vendimi i Gjykatës Speciale për krerët e UÇK-së

22:12 : 16/09/2026



Protestuesit e ndaluar ende në qeli, qytetarët zhvendosen te Blloku i Sigurisë: Nuk jeni vetëm!

22:02 : 16/09/2026



Reforma territoriale/ Banorët e Divjakës në ditën e 48-të të protestës

21:51 : 16/09/2026



VIDEO/ Kamioni kalon mbi të moshuarin dhe vijon rrugën, zbardhet dinamika e aksidentit në Kamëz

21:38 : 16/09/2026



E filmuan duke u marrë mijëra euro, noterja dhunon burrin dhe gruan shtatzënë

21:32 : 16/09/2026



‘Liria Ka Emër’/ Dua Lipa reagon ndaj vendimit në Hagë

21:20 : 16/09/2026

Më pas, brenda 21 ditësh nga njoftimi për apel, kryegjykatësi apo gjykatësi raportues e thërret një konferencë ku ngrihen çështje rreth apelit.

Palët që parashtrojnë apel duhet të dorëzojnë dosjen e apelit e cila përmban të gjitha argumentet dhe burime të tjera ligjore ku mbështeten arsyet e apelimit. Kjo duhet të dorëzohet brenda 60 ditësh apo brenda 30 ditësh nga njoftimi për apel, nëse çështja ka të bëjë vetëm me dënimin e shqiptuar.

Më pas palët dorëzojnë të ashtuquajturën dosje të përgjigjes, ku paraqesin argumentet ligjore të tyre. Afatet se kur dorëzohet kjo dallojnë: 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore dhe 15 ditë vetëm për dënimin nga paraqitja e dosjes. Kjo pasohet me dosjen e kundërpërgjigjes për të cilën afatet janë më të shkurtra, 15 dhe 10 nëse ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pas gjithë këtyre afateve, Gjykata e Apelit e cakton datën e një seance “nëse është e nevojshme”, thuhet në rregullore.

Rregullorja parasheh që palët mund të dorëzojnë prova shtesë gjatë procedurës së apelimit dhe nëse ato pranohen, pala tjetër mund të paraqesë kundërprova.

Gjatë vendimit, Paneli i Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, por edhe provat që veçse janë pjesë e dokumentacionit.

Sapo të përfundojnë parashtrimet nga palët, paneli i Apelit mblidhet dhe shqyrton çështjen dhe nxjerr aktgjykim për dokumentacionin e apelit dhe për çdo provë shtesë të pranuar.

Pra, Gjykata e Apelit mund të lërë në fuqi, të zhbëjë ose të ndryshojë aktgjykimin e trupit gjykues apo të mbahet rigjykim.

Megjithatë, nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit nuk mund të shqiptojë vendim më të rëndë se shkalla e parë.

Vendimi i apelit shqiptohet brenda 60 ditësh nga parashtrimi i fundit i palëve. Megjithatë, edhe për këtë mund të kërkohet kohë shtesë, por jo më shumë se një muaji dhe zgjatja e afatit duhet të arsyetohet.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë tri arsye për të cilat mund të dorëzohen apele për vendime të shkallës së parë: ndonjë gabim rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, ndonjë gabim faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë ose ndonjë gabim për sa i përket dhënies së dënimit.

Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e Apelit, çështja mund të dërgohet në Gjykatën Supreme dhe më pas në atë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Mbrojtësit e ish-presidentit, Hashim Thaçi, thanë se procesi i apelimit mund të marrë vite kohë.

Vendimi i trupit gjykues

Pas 41 muajsh të nisjes së gjyqimit, trupi gjykues gjeti fajtorë katër ish-eporët e UÇK-së për krime lufte, por rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit.

Sipas trupit gjykues, katërshja e UÇK-së, së bashku me udhëheqës të tjerë, kishin për qëllim pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik e institucional mbi një Kosovë të pavarur.

Sipas gjykatës, për realizimin e këtyre objektivave, ata kishin një qëndrim të përbashkët se disa persona që konsideroheshin pengesë për qëllimet e tyre duhej të “shënjestroheshin”, “eliminoheshin” ose “neutralizoheshin”.

Këta persona thuhet se përfshinin, ndër të tjera, anëtarë ose përfaqësues të forcave të tjera politike dhe ushtarake, veçanërisht persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), persona që konsideroheshin të lidhur me autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të komuniteteve romë dhe serbe.

Gjatë shpalljes së aktgjyqimit, trupi gjykues tha se ky qëllim i përbashkët ishte zbatuar përmes vrasjeve, arrestimeve dhe ndalimeve pa proces të rregullt ligjor, si dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik, frikësimit dhe përdorimit të asaj që në aktgjykim quhet “luftë speciale”.

Trupi gjykues tha se ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputeti Rexhep Selimi, kontribuan në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët.

Në rastin e Thaçit, trupi gjykues tha se ai kishte luajtur rol kyç në formulimin dhe zbatimin e qëllimit të përbashkët, teksa konstatoi se kishte marrë pjesë edhe personalisht në disa prej krimeve, duke përmendur rastin e Behajdin Allaqit.

Për Veselin, Gjykata Speciale përmendi pozitën e tij si shef i Drejtorisë së Zbulimit të UÇK-së, organ që, sipas konstatimeve të trupit gjykues, kishte përgjegjësi për identifikimin, vëzhgimin dhe neutralizimin e personave të dyshuar si “kolaboracionistë”. Dhomat e Specializuara thanë se ai nuk ndërmori hapa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e krimeve, megjithëse kishte dijeni për to.

Për Selimin, trupi gjykues konstatoi se ai kishte kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Gjykata theksoi se pozita e tij si inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së i jepte më pak pushtet mbi anëtarët e tjerë të UÇK-së, krahasuar me disa prej të akuzuarve të tjerë.

Ndërsa për Krasniqin, që në kohë të luftës kishte qenë zëdhënës i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, gjykata konstatoi se ai kishte përdorur pozitën, rolin si udhëheqës, pushtetin dhe statusin e tij për zbatimin e aspekteve kriminale të qëllimit të përbashkët./REL

Etiketa: denim gjykata speciale hage ish-kreret e UCK

Lajme të lidhura



'Liria Ka Emër'/ Dua Lipa reagon ndaj vendimit në Hagë

21:20 : 16/09/2026



Turqia dënon sulmin me dron ndaj Mekës në Arabinë Saudite

20:51 : 16/09/2026



Prishtina nuk qetësohet pas vendimit të Hagës/ Qindra qytetarë mbledhen para Qeverisë

20:40 : 16/09/2026



Gjenerali i NATO-s: Jam i shokuar me vendimin e Hagës! Thaçi nuk është kriminel

20:33 : 16/09/2026



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Goxhaj: Padrejtësi e organizuar

20:15 : 16/09/2026



Vuçiq i pakënaqur me vendimin e Hagës: Mos festoni ende

19:18 : 16/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

